



# Shkollat Publike Worcester

Worcester, Massachusetts



Zyra e Superintendent

Dr. John E. Durkin Administration  
Building  
20 Irving Street  
Worcester, Massachusetts 01609-2493

Tel. (508) 799-3115

FAX (508) 799-3119

Qershor 2022

Për Nxënësit, Familjet dhe Stafin e **Shkollës Tatnuck Magnet,**

Gjatë marrjes së mostrave të fundit të ujit për plumb dhe bakër, disa pajisje në shkollën tonë kishin nivele plumbi mbi kufirin e lejuar të plumbit dhe/ose Nivelit të Veprimit të bakërit. Mostrat u mbledhën nga të gjitha çezmat dhe pajisjet e përdorura për të pirë, gatuar dhe përdorime mjekësore. Kampionet janë marrë në çdo rubinet ose pajisje për të dy mostra, e para në ujin që qëndron në rubinet gjatë natës, si dhe për një kampion të shpëlarëjes pas hapjes së rubinetit. Për informacion mbi procedurat e mbledhjes së mostrave për mostrat e shkollave, ju lutemi shihni: <https://www.mass.gov/guides/sampling-for-lead-and-copper-at-schools-and-childcare-facilities>

Në përputhje me Manualin e Rishikur të 3Ts të USEPA, programi LCCA i MassDEP rekomandon që shkollat dhe programet e edukimit të hershëm dhe programet e kujdesit vlerësojnë dhe rregullojnë të gjitha rubinetat/ pajisjet e përdorura për pirje, përgatitjen e ushqimit dhe përdorim mjekësor me rezultate të plumbit mbi limitin e lejuar nga një laborator i Massachusetts prej 1ppb (0.001 miligram per liter (mg/L)) derisa të arrihet përqëndrimi më i ulët i mundshëm i plumbit. Niveli i Veprimit të Massachusetts për bakrin në ujin e pishëm është 1.3 mg/L (gjithashtu e njohur si pjesë në milion).

Për informacion nga MassDEP në lidhje me plumbin dhe bakrin në ujin e pishëm shikoni:

Plumbin: <https://www.mass.gov/lead-in-drinking-water>

Bakrin: <https://www.mass.gov/doc/fact-sheet-copper-and-your-health>

Për informacion nga Departamenti i Shëndetit Publik të Massachusetts për Plumbin dhe Bakrin shikoni:

<https://www.mass.gov/orgs/childhood-lead-poisoning-prevention-program>

## Rezultatet e Kampioneve dhe Plani Përkatës i Veprimit

Data e Kampionit	Lloji i Pajisjes së Kampionit	Vendndodhja e Kampionit	Rezultati i Plumbit mg/L	Rezultati i Plumbit mbas 30 sekondash rrjedhjeje mg/L	Razultati i Bakrit mg/L	Rezultati i Bakrit mbas 30 sekondash rrjedhjeje mg/L	Plani i Veprimit
4/21/2022	Pajisja për pirje uji	Korridor përballë me Zyrën Qëndrore	<b>0.0052</b>	0.00087	N/A	N/A	Mbajtja e pajisjes jashtë shërbimit deri në një njoftim tjetër
4/21/2022	Pajisja për pirje uji	Klasa 5	<b>0.032</b>	0.001	N/A	N/A	Mbajtja e pajisjes jashtë shërbimit deri në një njoftim tjetër

4/21/2022	Rubineti në klasë	Klasa 5	<b>0.0027</b>	N/A	N/A	N/A	Vendosni tabelën "Vetëm për larjen e duarve"
4/21/2022	Rubineti në klasë	Klasa 6	<b>0.047</b>	0.0008	N/A	N/A	Vendosni tabelën "Vetëm për larjen e duarve"
4/21/2022	Rubineti në klasë	Klasa 3	<b>0.0021</b>	Asgjë nuk u zbulua	N/A	N/A	Vendosni tabelën "Vetëm për larjen e duarve"
4/21/2022	Rubineti në klasë	Klasa 4	<b>0.13</b>	0.0014	<b>7.1</b>	0.28	Vendosni tabelën "Vetëm për larjen e duarve"
4/21/2022	Lavamani në infermieri	Zyra e infermierisë	<b>0.0028</b>	Asgjë nuk u zbulua	N/A	N/A	Të rrjedhë për 30 sekonda në fillim të ditës
4/21/2022	Rubineti në klasë	Klasa 2	<b>0.0027</b>	0.00023	N/A	N/A	Vendosni tabelën "Vetëm për larjen e duarve"
4/21/2022	Rubineti në klasë	Klasa e të folurës	<b>0.0015</b>	0.00041	N/A	N/A	Vendosni tabelën "Vetëm për larjen e duarve"
4/21/2022	Pajisja për pirje uji	Korridor jashtë banjove të bodrumit - majtas	<b>0.037</b>	0.001	N/A	N/A	Mbajtja e pajisjes jashtë shërbimit deri në një njoftim tjetër
4/21/2022	Tjetër - lavaman	Korridor jashtë Klasës 21	<b>0.0086</b>	0.0004	N/A	N/A	Vendosni tabelën "Vetëm për larjen e duarve"

Kufiri i Massachusetts për zbulimin e Plumbit është 0.001 mg/L dhe Niveli i Veprimit për bakrin është 1.3 mg/L

Shkollat Publike Worcester (WPS) i merr këto rezultate shumë seriozisht dhe po ndërmer hapa për të adresuar problemet e identifikuar. Ne jemi duke punuar ngushtë dhe në bashkëpunim me MassDEP.

***Përveç veprimeve specifike në shkollën tuaj, Shkollat Publike Worcester po kryejnë aktivitetet e mëposhtme në të gjithë distriktin:***

1. Vendosja e tabelave të tilla si "*Tabela Vetëm për Larjen e Duarve*" në pajisjet me nivele plumbi dhe/ose bakri mbi kufirin e zbulimit të plumbit dhe/ose Nivelin e Veprimit të bakrit që nuk përdoren për ujë të pijshëm ose për përgatitjen e ushqimit. Shumë nga pajisjet mbi nivelet e veprimit në distrikt ishin lavamanë të përdorur vetëm për larjen e duarve. Departamenti i Shëndetësisë në Massachusetts deklaroi se uji që përmban plumb ose bakër nuk është i dëmshëm nëse përdoret për larjen e duarve
2. Japin informacion për nxënësit, familjet, stafin dhe zyrtarët lokalë.
3. Komunikimin me departamentet e Shkollave Publike Worcester si Ushqyerja, Infermiera etj., për të zbatuar planet e veprimit, sipas nevojës
4. Garantimin që ka ujë të mjaftueshëm për të pirë dhe për përgatitjen e ushqimit nëse duhet t'i nxjerrim përkohësisht pajisjet jashtë linjës për të kryer kampionime të mëtejshme ose për të zbatuar veprime korigjuese. Të gjithë dispenserat e ujit, makineritë për mbushjen e shisheve të ujit kanë

qenë jashtë linje përpara kthimit në mësimin në-person në Mars 2021. Uji në shishe u është vënë në dispozicion të gjithë nxënësve dhe stafit gjatë kësaj kohe.

### ***Burimet dhe Marrja e Kampioneve të Plumbit dhe Bakrit në Ujin e Pijshëm***

Në Massachusetts, shumica e burimeve të ujit të pijshëm nga rezervuarët dhe ujërat nëntokësore nuk përmbajnë nivele të larta plumbi ose bakri. Plumbi hyn në ujin e pijshëm kryesisht duke u kulluar nga tubacionet hidraulike që përmbajnë plumb, si p.sh. linja e shërbimit të plumbit (të gjitha linjat e njohura që përmbajnë plumb janë hequr) që lidhin një ndërtesë me rrjetin e ujit në rrugë, ose nga tubacionet hidraulike dhe instalimet brenda një ndërtese. Bakri hyn në ujin e pijshëm kryesisht duke u kulluar nga tubacionet hidraulike që përmbajnë bakër.

Kullimi i plumbit dhe bakrit ka më shumë gjasa të ndodhë kur uji nxehet ose nuk lëviz, përgjithësisht gjatë natës ose në raste të tjera kur uji nuk përdoret për disa orë. Prandaj, MassDEP kërkon që nga pajisjet të merren mostra herët në mëngjes pasi uji në ndërtesë nuk është përdorur gjatë natës.


### ***Një Kujtesë nga MassDEP***

Sistemi i ujit në shkollë nuk është ndryshe nga sistemet e ujit që gjenden në ndërtesa të tjera. Sistemet dhe pajisjet e vjetra hidraulike, veçanërisht, mund të përmbajnë tuba plumbi ose saldim që mund të lejojnë plumbin të hyjë në ujin e rubinetit.

**Ju lutemi vini re se për shkak të shqetësimeve në lidhje me Covid-19, pajisjet të tilla si dispenserat e ujit dhe makineritë për mbushjen e shisheve të ujit kanë qenë jashtë linje dhe të padisponueshme për përdorim gjatë dy viteve të fundit. Uji në shishe i është ofruar të gjithë stafit dhe nxënësve që nga kthimi në mësimin në-person në Mars 2021. Ne po punojmë me përkushtim për të vlerësuar të gjitha burimet e ujit të pijshëm në ndërtesat tona dhe për t'i vënë ato në dispozicion për përdorim gjatë vitit të ardhshëm shkollor 2022 – 2023.**

Nëse keni ndonjë pyetje mbi këtë informacion, ju lutemi kontaktoni Departamentin e Objekteve (Facilities) të Shkollave Publike Worcester në (508) 799-3151.

Sinqerisht,



***Superintendent i Shkollave***